

9.6 KONTROLI I NJËSUAR

Te procedurat me kontroll të njësuar është e rëndësishme, që fillimisht të verifikohet nëse regjistrimi për entitetin tashmë ekziston në bazën e njësuar të të dhënave. Duhet të verifikohen të gjitha format e mundshme të emrave, që gjenden në regjistrimet bibliografike ose në burimet e tjera.

Shumica e kërkimeve apo verifikimeve në bazat bibliografike apo të njësuara të të dhënave kryhen para se të fillohet shënimi i të dhënave.

Kërkimin në baza të ndryshme të të dhënave mund ta bëni edhe nga redaktuesi.

Të dhënat, të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar pikëqasjen e entitetit dhe krijimin e regjistrimit të njësuar, i kontrolloni në burimet e ndryshme referuese dhe në burimet e tjera që i keni në dispozicion. Mund t'i shfrytëzoni edhe të dhënat në bazat e njësuara dhe bibliografike të të dhënave.